



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
Komisioni Institucional i Zgjedhjeve

V E N D I M

Nr. 33, Datë 07/05/2024

“Për plotësimin e 2 (dy) vendeve vakant për anëtar – personelit akademik, në Komisionin e Zgjedhjeve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të UT-së dhe fillimin e procesit të vetëkandidimit për këto vende”

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës”, Kreu II, neni 7; Vendimit nr. 30, datë 07.05.2024 të KIZ, në mbledhjen e mbledhjen e të njëjtës datë, KIZ:

VENDOSI:







1. Shpalljen e fillimit të procesit të vetëkandidimit për plotësimin e 2 (dy) vendeve vakante për anëtar - përfaqësues i Personelit Akademik, respektivisht, në Departamentin e Gjuhës Spanjolle dhe në Departamentin e Gjuhës Angleze, në Komisionin e Zgjedhjeve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, të UT-së, duke respektuar, për sa mundet parimin e përfaqësimit të njësisë bazë në KZF-në, e njësisë kryesore;

Adresa: Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë



2. Aplikimi i kandidatëve për këto vende, fillon në datën 08.05.2024 dhe përfundon në datën 10.05.2024, nga ora 08:00 – 14:30. Aplikimi i kandidatëve kryhet pranë Sekretarisë Teknike të KIZ, pranë Rektoratit të UT-së, ose elektronikisht, në adresën kizut2021@unitir.edu.al, sipas formularëve bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Ky Vendim dërgohet për zbatim në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, të UT-së.
4. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të UT-së dhe të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, si dhe në mjediset e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

- | | | |
|---------------------|-----------|---|
| 1. Leticja Gusho | (Kryetar) |  |
| 2. Alnida Koroshi | (Anëtar) |  |
| 3. Eljon Doçe | -//- |  |
| 4. Etlon Peppo | -//- |  |
| 5. Shaniko Allajbeu | -//- |  |
| 6. Dhurata Saraçi | -//- |  |

